



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË**

ZYRA PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAN

Rr. Jordan Misja, Blv Zhan d'Ark, Tiranë, adresë web: www.gjykata.gov.al

Datë 22.07.2026

NJOFTIM PËR MEDIAN

Mbi interesimin publik të shfaqur, komunikojmë në mënyrë zyrtare informacionin si vijon më poshtë:

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pasi zhvilloi seancën gjyqësore, për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ndaj personave nën hetim A.S dhe G.S, të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit, pasi dëgjoi pretendimet e Prokurorit, të mbrotjesve të të pandehurve, si dhe të pandehurve, Gjykata u tërhoq për të shpallur vendimin dhe si u kthye në bazë të Nenit 248, 47, 48/ç, 50-60 të Kodit Penal dhe Nenit 383, 406/1, 379 383, 384, 390 dhe 190 të Kodit Proçedurës Penale:

V E N D O S I

1-Deklarimin fajtor të të pandehurit **A. S.** për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe në bazë të Nenit 248 të Kodit Penal e dënon atë me 9 (nëntë) muaj burgim.

-Në bazë të Nenit 406 të Kodit Proçedurës Penale mbas uljes së dënimit me 1/3 i pandehuri **A. S.** dënohet me një dënim të vetëm përfundimtar prej 6 (gjashtë) muaj burgim.

-Në zbatim të Nenit 59 të Kodit Penal (të ndryshuar me Ligjin 36/2017 dt. 30.03.2017, Neni 3/3), Gjykata urdhëron pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 1 (një) vit me kusht që ai të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë dhe brenda kësaj periudhe të mos kryej vepër tjetër penale.

2-Deklarimin fajtor të të pandehurit **G. S.** për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe në bazë të Nenit 248 të Kodit Penal e dënon atë me 9 (nëntë) muaj burgim.

-Në bazë të Nenit 406 të Kodit Procedurës Penale mbas uljes së dënimit me 1/3 i pandehuri **G. S.** dënohet me një dënim të vetëm përfundimtar prej 6 (gjashtë) muaj burgim.

-Në zbatim të Nenit 59 të Kodit Penal (të ndryshuar me Ligjin 36/2017 dt. 30.03.2017, Neni 3/3), Gjykata urdhëron pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 1 (një) vit me kusht që ai të mbajë kontakte me Zyren Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë dhe brenda kësaj periudhe të mos kryej vepër tjetër penale.

-Prova materiale sekuestruar të pandehurit **G. S.** me nr. . e vlefshme deri në dt. 19.08.2030, të kthehet këtij të fundit.

-Shpenzimet proceduriale të kryera në fazën e hetimeve paraprake si edhe ato gjyqësore iu ngarkohen solidarisht të pandehurve.

-Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tiranë më datë 21 Korrik 2026.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

e-mail: ola.ismaili@gjykata.gov.al